

**STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
KELMENDI – E DISTRIBUTION**

KREU 1

Themelimi , Emri , Objekti , Kohezgjatja dhe Selia

Neni 1 : Data e themelimit , Emri dhe themeluesit

Sot me date 16.04.2020 , kerkohet themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **KELMENDI – E DISTRIBUTION** dhe formulimi i statutit te saj si me poshte vijon, ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “ nga ortaket:

Z. Elton Kelmendi i datëlindjes 14.10.1980, identifikuar me nr.perosnal ID I01014045K, me shtetesi Shqiptare.

Z. Ramazan Blaka i datëlindjes 15.09.1994, identifikuar me nr.perosnal ID J40915076F, me shtetesi Shqiptare.

Neni 2 : Objekti

Import - Export, shitje me shumice dhe pakice e mallrave ushqimore. Import – Export dhe shitje e mallrave te ndryshem industrial me shumice dhe pakice. Import – Export material ndertimi dhe tregtimi I tyre.

Logjistike, magazinim, shperndarje dhe transport mallrash per llogari te vet dhe per te trete.
Import – Export, tregti me shumice e pakice dhe distribucion te pijeve alkolike, joalkolike, detergjente te ndryshem

Neni 3 : Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do jete pa afat.

Neni 4 : Selia

Selia shoqerise eshte: Rruga Nacionale Plepa – Ndroq, km2, nr. Pasurie 247/25, Arapaj, Durres.

Shoqeria mund te ndryshoje seline, te hape filiale , dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin Shqiptar dhe jashte vendit .

KREU II KAPITALI I RREGJISTRUAR

Neni 5 : Vlera dhe pagesat e kapitalit te rregjistruar

Kapitali i shoqerise eshte 1000 (njemije) Leke , i ndare ne 2 (dy) kuota.

Kontributi i ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte vleresuar sipas te dhenave te meposhtme :

Z. Elton Kelmendi i cili zoteron 1 kuote , me 70 (shtatedhjete)% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, me 700 Lek kontribut ne kapital.

Z. Ramazan Blaka i cila zoteron 1 kuote, me 30 (tridhjete) % te pjesemarrjes ne kapital, me 300 Lek kontribut ne kapital.

Neni 6 : Pagesa e kuotave

Administratoret mund ti kerkojne ortakeve pagimin e kontributeve ne para te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre .

Neni 7 : Kalimi i kuotave

Kalimi i kuotave dhe i te drejtave qe rrjedhin prej tyre , mund te behet me kontrate shitblerje , me dhurim , me trashegimi ose me cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj .

Neni 8 : Zmadhimi e zvogelimi i kapitalit themeltar

Asambleja e Pergjithshme , me shumice te kualifikuar , mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve .

Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme , te marre me shumice te kualifikuar te votave .

Kreu III

Asambleja e Pergjithshme

Neni 9 : Te drejtat dhe detyrimet

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme :

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise ,
- b) ndryshimet e statutit ,
- c) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve ,
- d) emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar ,
- e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret , perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ,
- f) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit ,
- g) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre ,
- h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve ,
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise ,
- j) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese ,
- k) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti .

Neni 10 : Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- a) Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori te pakten 2 here ne vit , per te miratuar perkatesisht bilancin vjetor te mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues .
- b) Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje shkrese derguar cdo ortaku me poste te zakonshme ose mesazh elektronik . Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen .
- c) Ortaket ,qe zoterojne te pakten 30% te kapitalit te rregjistruar kane te drejte te therrasin mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme nepermjet administratorit ose dhe pa ndermjetesimin e tij .

Neni 11 : Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

a) Mbledhja e Asamblese eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 50% te aksioneve , per te vendosur per ceshtje te zakonshme . Ne kete rast vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga shumica e votave te ortakeve pjesemarres , (e cilesuar ne kete statut si “ shumice e thjeshte “) .

b) Mbledhja e Asamblese , per te vendosur per ceshtje te vecanta si : ndryshimi i statutit , zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te rregjistruar , shperndarja e fitimeve , riorganizimi dhe prishja e shoqerise , eshte e vlefshme , eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 60 % te kuotave . Ne kete rast vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga jo me pak se tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres , (e cilesuar ne kete statut si “ shumice e kualifikuar “) .

c) Mbledhja e Asamblese drejtohet nga administratori nese eshte e thirrur prej tij . Nese Asambleja e Pergjithshme eshte thirrur nga pakica , atehere ajo kryesohet nga njeri nga ortaket e zgjedhur nga pjesemarresit ne ate mbledhje .

d) Administratori pavaresisht se nuk eshte ortak , ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marri fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se pergjithshme .

Neni 12 : Votat e Pjesemarresve

a) Cdo ortak ka te drejta vote ne perpjesetimin me vleren nominale te kuotes se tij .

b) Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet , qe kane te bejne me kuotat , qe ai disponon .

Neni 13 : Emerimi i Administratorit

a) Administrimi si dhe perfaqesimi i shoqerise i besohen nje ose me shume Administratoreve te cilet per shoqerine KERMENDI – E DISTRIBUTION mund te jene ne te njejten kohe dhe ortak te saje.

b) Administratori emerohet maksimumi per 1-vjet nga regjistrimi i shoqerise prane QKR-se , me te drejte riprertitje , me perjashtim doreheqje apo shkarkimi nga ana Asamblese .

c) Detyra e Administratorit i ngarkohet:

Z. Ramazan Blaka i datëlindjes 15.09.1994, identifikuar me nr.përsnal ID J40915076F, me shtetesi Shqiptare

d) Asambleja e Pergjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorin nga detyra, me shumicë të zakonshme votash, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 50% të kuotave.

Neni 14 : Kompetencat e Administratoreve

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohet :

a. të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Pergjithshme,

b. të përfaqësojnë shoqërinë,

c. të kujdesen për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë,

d. të bëjnë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor parashikues për vitin e ardhshëm, për tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme, brendë datës 31 mars të vitit paraardhës.

e. të bëjnë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor të mbyllur, për tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme, brendë datës 20 mars të vitit të ardhshëm dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Pergjithshme për miratim,

f. të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,

g. të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë

h. të raportojnë përpara Asamblesë së Pergjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,

i. të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe statut.

Neni 15 : Mbledhjet e Administratoreve

Administratoret kujdeset qe ne libra te posacem te mbaje proces verbalet e te gjitha takimeve te kryera nga ata , si dhe te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme .

Kreu VI

Shperndarja e fitimit vjetor te shoqerise

Neni 16 : Shperndarja e fitimit vjetor

- a) Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise , vendoset te shperndahet nga Asambleja e Pergjithshme .
- b) Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar , qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne .
- c) Po ashtu , Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve , por keto shume te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera , te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine .

Kreu VII

Prishja dhe njoftimet

Neni 17 : Prishja dhe likuidimet

- a) Ne rast te likuidimit te shoqerise , Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator , i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit .
- b) Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme , te marre me shumice te kualifikuar , pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise , likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve . Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar , qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne .

Neni 18 :Ftesa per kreditoret

Likuiduesit duhet te ftojne kreditoret per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj . Shoqeria e publikon dy here kete njoftim , me nje interval prej 30 ditesh , ne faqen e saj te internetit , si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit . Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit .

Neni 19 : Perfundimi i likuidimit

- a) Pas shperndarjes se aktiviteteve te mbetura , likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise .
- b) Vepriimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit .

Neni 20 : Dispozitat e fundit

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e ketij statuti . Per cdo gje tjeter , qe nuk eshte shkruar shprehimisht ne kete statut , zbatohet legjislacioni ne fuqi per shoqerine tregtare , per QKR-ne si dhe cdo ligj tjeter mbi veprimtarine e shoqerive me eprgjegjesi te kufizuar .

Ortaket themelues

Elton Kelmendi



Ramazan Blaka

